Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

2017/I

RAPORTI I REFEROHET DEKLARATËS SË POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2016, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 02, DATË 01.02.2017

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje
Shtypur nga *sh.p.k.*

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI 7

FJALA E GUVERNATORIT 9

1. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË 12

2. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË 15

2.1. Ekonomia botërore 15
2.2. Ecuria e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet botërore 19

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE 21

3.1. Zhvillimet në tregjet financiare 21
3.2. Normat e interesit të depozitave dhe kredive dhe kushtet e financimit 25
3.3. Kreditimi i sektorit privat 27
3.4. Financimi i sektorit publik 29
3.5. Ecuria e depozitave dhe e parasë në ekonomi 30

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE 32

4.1. Ecuria e inflacionit 32
4.2. Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate 34
4.3. Gjendja ciklike e ekonomisë dhe presionet e brendshme inflacioniste 48
4.4. Inflacioni i importuar 54
4.5. Pritjet për inflacionin 55

SHTOJCA STATISTIKORE 57

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1: Ecuria e çmimeve në tregun e banesave 42
Hapësirë informuese 2: Zhvillimet në Bilancin e Pagesave në tremujorin e tretë të vitit 2016 47
Hapësirë informuese 3: Prodhimi potencial, norma natyrore e papunësisë dhe hendekët përkatës: përfundime të vlerësimeve për Shqipërinë 50

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2. Ambienti i jashtëm i ekonomisë
Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë 16
Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje 19

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike
Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor 34
Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave 48

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

1. Stabiliteti i çmimeve dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë

Grafik 1. Ecuria e normave kryesore të interesit në tregjet financiare shqiptare 13

2. Ambienti i jashtëm i ekonomisë

Grafik 2. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe Prodhimi Industrial i vendeve kryesore dhe inflacioni i vendeve kryesore 15
Grafik 3. Indeksi i përbërë i prodhimit (PMI) dhe PBB-ja tremujore dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin, konsumatorët dhe ndjesinë ekonomike 17
Grafik 4. Ndryshimet vjetore të çmimeve të mallrave bazë 19
Grafik 5. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 20
Grafik 6. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 20

3. Tregjet financiare dhe zhvillimet monetare

Grafik 7. Normat e interesit në tregun ndërbankar dhe devijimi i tyre nga norma bazë 22
Grafik 8. Operacionet e tregut të hapur të BSH dhe vëllimi i tregtuar në tregun ndërbankar në miliardë lekë 22
Grafik 9. Ecuria e kursit të këmbimit 23
Grafik 10. Yield-et në tregun primar 24
Grafik 11. Normat e interesit për depozitat e reja 25
Grafik 12. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore 26
Grafik 13. Kushtet e kreditimit 27
Grafik 14. Ecuria e kredisë për sektorin privat 27
Grafik 15. Ecuria e kredisë për individë 28
Grafik 16. Ecuria e kredisë për biznese 29
Grafik 17. Deficiti buxhetor dhe instrumentet e financimit të tij 29
Grafik 18. Ecuria e treguesve monetarë 30
Grafik 19. Ecuria e depozitave ndaj PBB-së dhe sipas monedhës 31
Grafik 20. Ecuria e depozitave sipas maturiteteve 31
Grafik 21. Inflacioni vjetor dhe objektivi. Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE 32

4. Inflacioni dhe rritja ekonomike

Grafik 22. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total 33
Grafik 23. Ecuria vjetore dhe tremujore e PBB-së 35
Grafik 24. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit 36
Grafik 25. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve 36
Grafik 26. Ecuria e vlerës së shtuar në ndërtim dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 37
Grafik 27. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve 38
Grafik 28. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme 39
Grafik 29. Ecuria e konsumit privat 40
Grafik 30. Tregues të tërthortë për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e katërt 40
Grafik 31. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore 41
Grafik 32. Tregues afatshkurtër të investimeve për tremujorin e katërt 42
Grafik 33. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave dhe raporti i tyre 42
Grafik 34. Orientimi i politikës fiskale 43
Grafik 35. Ecuria e shpenzimeve buxhetore 44
Grafik 36. Ecuria e të ardhurave buxhetore 44
Grafik 37. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate 45
Grafik 38. Ecuria vjetore e çmimit të naftës në tregun Brent, e eksportit të naftës vendase, e indeksit të çmimit të metaleve dhe e eksportit të metaleve vendase 46
Grafik 39. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive 46
Grafik 40. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë 49
Grafik 41. Hendeku i prodhimit dhe i normës së papunësisë 51
Grafik 42. Ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit 53
Grafik 43. Prirjet afatgjata të inflacionit dhe prirjet afatshkurtra 54
Grafik 44. Kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor. TPHI-ja dhe kontributet e përbërësve të tij 55
Grafik 45. Pritjet inflacioniste nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë 55

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar, janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0% në një periudhë afatmesme. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon çdo tre muaj Raportin e Politikës Monetare. Ky Raport është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Ai paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti i referohet deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.02, datë 01.02.2017. Analiza ekonomike, financiare dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit në dispozicion, deri më 20 janar 2017.

FJALA E GUVERNATORIT

Informacioni i analizuar në këtë raport konfirmon vlerësimet e mëparshme të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen aktuale dhe zhvillimet e pritura të ekonomisë shqiptare.

Të dhënat e disponuara sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në vend vazhdon të shënojë rritje. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka sjellë përmirësime në treguesit e tregut të punës dhe është pasqyruar në një rritje graduale të inflacionit drejt objektivit. Politika monetare lehtësuese, e pasqyruar në reduktimin e kostove të financimit dhe në uljen e primeve të rrezikut, mbetet një faktor vendimtar në këtë tablo zhvillimi. Parashikimet për të ardhmen mbeten pozitive. Banka e Shqipërisë pret një forcim të rritjes ekonomike gjatë dy viteve të ardhshme dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2018.

Inflacioni ka ardhur në rritje gjatë muajve të fundit, duke shënuar një normë vjetore prej 2.2% në muajin dhjetor. Në aspektin e kompozimit, rritja e inflacionit gjatë tremujorit të katërt erdhi si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe të naftës. Në aspektin makroekonomik, trendi rritës i inflacionit gjatë kësaj periudhe reflekton shtimin e presioneve inflacioniste nga mjedisi i brendshëm dhe reduktimin e presioneve dezinflacioniste nga mjedisi i huaj.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 3.3% gjatë nëntë muajve të parë të vitit dhe me 3.1% në tremujorin e tretë të tij. Rritja ekonomike pasqyroi zgjerimin e konsumit dhe të investimeve private, si dhe rritjen e të ardhurave nga turizmi. Kërkesa e brendshme gjeti mbështetje nga kushtet monetare stimuluese, nga përmirësimi i besimit, nga rritja e punësimit dhe nga zgjerimi i investimeve të huaja direkte. Nga ana tjetër, kërkesa e huaj kontribuoi pozitivisht në rritjen e eksportit të shërbimeve, por eksportet e mallrave vazhdojnë të shfaqin një ecuri të dobët, si pasojë e çmimeve ende të ulëta të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare.

Në gjykimin tonë, rritja ekonomike e tremujorit të katërt do të jetë më e lartë se ajo e tremujorit paraardhës. Rritja ekonomike e gjithë vitit 2016 do të jetë e përafërt me atë të nëntëmujorit të parë dhe më e lartë se ajo e vitit 2015.

Zgjerimi i kërkesës agregate ka sjellë rritjen e punësimit dhe reduktimin e papunësisë. Të dhënat e tremujorit të tretë tregojnë një rritje vjetore të punësimit me 8.5% dhe një rënie të normës së papunësisë në nivelin 14.7%.

Zhvillimet ekonomike e financiare kanë pasqyruar efektin e kombinuar të politikës fiskale konsoliduese dhe të politikës monetare lehtësuese të ndjekur përgjatë vitit.

Balanca fiskale e njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit rezultoi me një suficit prej 7.1 miliardë lekësh. Në këtë rezultat ndikuan rritja vjetore me 7.3% e të ardhurave dhe rënia vjetore me 2% e shpenzimeve. Ky kurs i politikës fiskale ka mbajtur të ulët kontributin direkt të shpenzimeve publike në kërkesën agregate, por ka krijuar më shumë hapësira për transmetimin e politikës sonë monetare në tregjet financiare.

Stimuli ynë monetar ka krijuar kushte të favorshme financiare, ndonëse kursi i këmbimit paraqitet i mbiçmuar në raport me një vit më parë. Niveli i ulët i normës bazë të interesit ka kontribuar në reduktimin e normave të interesit në të gjitha produktet e tregut financiar të destinuara për sektorin privat. Në veçanti, interesi mesatar i kredisë në lekë në muajin nëntor ishte 0.6 pikë përqindje më i ulët nga një vit më parë. Nga ana tjetër, *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar kanë shfaqur rritje gjatë muajve të fundit. Kjo ecuri ka pasqyruar pjesërisht një korrektim të rënies së tyre të shpejtë në pjesën e parë të vitit dhe pjesërisht efektet e luhatjeve të raportit kërkesë – ofertë. Tendenca rritëse pritet të vijë duke u zbehur, për sa kohë politikat monetare dhe fiskale mbeten të pandryshuara. Gjithashtu, të dhënat e disponuara sugjerojnë se kjo tendencë nuk është pasqyruar në shtrëngimin e çmimit të kredisë për sektorin privat, duke mos deformuar përcjelljen e politikës sonë monetare.

Në përgjigje të kësaj politike, si dhe në reflektim të gjallërimit të aktivitetit ekonomik, kredia për ekonominë ka ardhur në rritje. Duke përjashtuar efektin e nxjerrjes së kredive të humbura nga bilanci, portofoli i kredisë për sektorin privat në muajin nëntor ishte 3.4% më i lartë se një vit më parë. Më në detaje, rritja me 10.4% e portofolit të kredisë në monedhën vendase ka kompensuar tkurrjen me 1.4% të portofolit të kredisë në monedhë të huaj.

Banka e Shqipërisë pret një përmirësim të mëtejshëm të kreditimit gjatë vitit 2017. Këto pritje mbështeten në sinjalet për një gjallërim gradual të kërkesës për kredi, si dhe në efektet pozitive në ofertë që do të sjellë realizimi i planit të masave për reduktimin e kredive me probleme. Duke u ndalur te këto të fundit, të dhënat tregojnë se raporti i kredive me probleme zbriti në 18.2% në muajin dhjetor. Ky reduktim pasqyron efektet e kombinuara të përmirësimit të situatës ekonomike, të ristrukturimit të kredive dhe të nxjerrjes së kredive të humbura nga bilanci.

Analiza e mësipërme sugjeron se kushtet ekonomike dhe financiare janë të përshtatshme për kthimin e inflacionit në objektiv. Rritja ekonomike parashikohet të forcohet më tej gjatë dy viteve të ardhshme, duke krijuar premisat e duhura për kthimin e ekonomisë në ekuilibër dhe të inflacionit në objektiv brenda vitit 2018. Për vitin 2017, Banka e Shqipërisë pret një inflacion mesatar në nivelin 2.3%, kundrejt nivelit 1.3% të shënuar në vitin 2016.

Përmbushja e këtij skenari kërkon ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare, edhe gjatë periudhës afatmesme. Megjithatë, intensiteti i stimulit monetar gjatë kësaj periudhe do të ndjekë trendin e përmirësimit të ekonomisë, duke qenë

gjithnjë i përshtatur me nevojat e ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë. Duke u nisur nga informacioni i disponuar, si dhe duke gjykuar mbi balancën e rreziqeve, e cila vazhdon të qëndrojë në kahun e poshtëm, Këshilli Mbikëqyrës gjykon se intensiteti i stimulit monetar nuk do të ulet përpara tremujorit të katërt të vitit 2017.

Ndjekja e këtij kursi të politikës monetare është në përputhje me përmbushjen e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve. Paralelisht me të, politika monetare stimuluese krijon kushte të përshtatshme edhe për zbatimin e reformave strukturore. Këto reforma janë të nevojshme – ndër të tjera – për zgjerimin e mëtejshëm të potencialit prodhues të vendit dhe për rritjen e rezistencës së ekonomisë ndaj goditjeve të mundshme.

1. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë hartohet dhe zbatohet në përmbushje të objektivit të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Prej disa vitesh, dobësia ciklike e ekonomisë dhe presionet e dobëta inflacioniste kanë kërkuar ndjekjen e një politike monetare stimuluese. Banka e Shqipërisë ka reaguar nëpërmjet uljes së njëpasnjëshme të normës bazë të interesit dhe furnizimit me likuiditet të sistemit bankar. Stimuli monetar ka kontribuar në reduktimin e kostove të financimit dhe në përmirësimin e flukseve monetare të agjentëve ekonomikë. Paralelisht, komunikimi i hapur për ruajtjen e normave të ulëta të interesit ka ndikuar në reduktimin e primeve të rrezikut. Nëpërmjet këtyre instrumenteve, politika monetare stimuluese ka luajtur një rol parësor për nxitjen e kërkesës së brendshme private, për fuqizimin e rritjes ekonomike dhe për vendosjen e inflacionit në një trajektore konverguese drejt objektivit.

Kahu lehtësues i politikës monetare është ruajtur edhe gjatë vitit 2016, duke kontribuar në rikuperimin e ekonomisë, në rritjen e inflacionit dhe në ankorimin më të mirë të pritjeve inflacioniste. Ecuria e aktivitetit ekonomik gjatë gjysmës së dytë të vitit ka qenë pozitive dhe pritjet tona janë për forcimin e këtyre tendencave në afatin e mesëm. Stimuli monetar vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur rritjen e ekonomisë drejt ekuilibrit dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2018. Pavarësisht këtij skenari pozitiv, rreziqet e kahut të poshtëm vazhdojnë të dominojnë në afatin e mesëm. Në këtë kontekst, politika monetare do të vazhdojë të mbetet stimuluese, por intensiteti i stimulit monetar do të përshtatet me nevojat e ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë.

Aktiviteti ekonomik në Shqipëri ka vijuar të shfaqë ecuri pozitive dhe presionet inflacioniste janë forcuar. Bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 3.1% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, ndërkohë që inflacioni arriti nivelin 2.2% në fund të vitit. Rritja e inflacionit i atribuohet kryesisht rritjes së inflacionit të çmimeve të ushqimeve dhe të naftës, ndërsa artikujt e tjerë të shportës kanë pasur kontribute të ulëta. Prirja rritëse e inflacionit reflekton shtimin e presioneve të brendshme inflacioniste, frenimin e presioneve të huaja dezinflacioniste dhe ankorimin më të mirë të pritjeve për inflacionin. Në vlerësimin tonë, kushtet monetare janë të përshtatshme për të mbështetur rritjen ekonomike dhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Ekonomia ka shënuar ritme të qëndrueshme rritjeje përgjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016. Burimet kryesore të rritjes vijojnë të jenë konsumi dhe investimet, të mbështetura nga kushtet monetare stimuluese, nga përmirësimi i besimit të agjentëve ekonomikë, nga rritja e punësimit dhe nga zgjerimi i investimeve të huaja. Në tremujorin e tretë, një kontribut të rëndësishëm dhanë eksportet e shërbimeve, të cilat shënuan një rritje të vrullshme në zërin e të

ardhurave nga turizmi. Vlerësimet tona paraprake tregojnë se ky profil rritjeje është mbartur edhe në tremujorin e fundit të vitit. Për vitin 2016, aktiviteti ekonomik vlerësohet të jetë zgjeruar me një normë më të lartë se ajo e vitit 2015.

Politika monetare stimuluese ka përmirësuar kushtet e financimit në ekonomi dhe ka siguruar mbështetje për rritjen e saj. Stimuli monetar është përcjellë nëpërmjet instrumentit të normës bazë të interesit, nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit, si dhe nëpërmjet orientimit të tregjeve financiare për kursin e ardhshëm të politikës monetare. Norma bazë e interesit është ulur 0.50 pikë përqindje në gjysmën e parë të vitit 2016 dhe qëndron në nivelin më të ulët historik, prej 1.25%.

Kushtet e financimit janë përmirësuar për të gjitha segmentet e tregut financiar. Interesi mesatar i kredisë në lekë ka zbritur në nivelin 7.5% për vitin 2016[1], duke qëndruar 0.6 pikë përqindje nën mesataren e vitit 2015 dhe 1.1 pikë përqindje nën mesataren e vitit 2014. *Yield*-i mesatar ka zbritur në nivelin 1.8% për vitin 2016, duke qëndruar 1.5 pikë përqindje më ulët se niveli i vitit 2015 dhe 1.6 pikë përqindje më ulët se në vitin 2014. Kushtet e tjera të kreditimit janë lehtësuar për individët e ndërmarrjet e vogla e të mesme, ndërkohë që mbeten të shtrënguara për ndërmarrjet e mëdha. Ndërmjetësimi në monedhën vendase ka vazhduar të rritet, në kontekstin e përshpejtimit të rritjes ekonomike dhe të kostove më të ulëta të financimit. Kreditimi në lekë vijoi trendin rritës, duke qenë kontribuesi i vetëm në zgjerimin e kredisë për sektorin privat edhe për vitin 2016. Zgjerimi vjetor i kredisë në lekë arriti në 10.4% në muajin nëntor, nga 5% një vit më parë.

Grafik 1. Ecuria e normave kryesore të interesit në tregjet financiare shqiptare



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të DPM.

[1] *Të dhënat për vitin 2016 janë deri në muajin nëntor.*

Rritja më e shpejtë e ekonomisë dhe e kërkesës agregate ka aktivizuar një pjesë të kapaciteteve të lira në ekonomi, duke sjellë rritjen e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, rritjen e punësimit dhe reduktimin e normës së papunësisë. Shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve prodhuese ka kontribuar në rritjen e presioneve të brendshme inflacioniste dhe të inflacionit bazë. Këto tendenca pritet të vazhdojnë edhe gjatë këtij viti duke mbështetur rritjen graduale të inflacionit drejt objektivit të bankës qendrore.

Inflacioni parashikohet të shënojë vlerën mesatare prej 2.3% për vitin 2017, kundrejt nivelit mesatar 1.3% të shënuar gjatë vitit 2016. I mbështetur nga politika monetare lehtësuese dhe rikuperimi i vazhduar i ekonomisë, inflacioni pritet të kthehet në objektiv brenda vitit 2018. Përmbushja e parashikimeve mbetet e kushtëzuar nga ruajtja e një politike monetare lehtësuese edhe gjatë horizontit afatmesëm. Kjo nënkupton ruajtjen e normave të interesit poshtë atyre ekuilibër.

Balanca e rreziqeve rreth skenarit bazë vlerësohet e përmirësuar në afat të shkurtër, e ndikuar në kahun pozitiv nga një përmirësim më i shpejtë se ai i pritur i besimit të agjentëve ekonomikë dhe i tregtisë së jashtme. Në afat të mesëm, rreziqet e kahut të poshtëm janë më dominuese, të lidhura kryesisht me pasiguritë në mjedisin e huaj dhe me shpejtësinë e rikuperimit të kredisë.

Konfirmimi i pritjeve tona afatmesme dhe i balancës së rreziqeve rreth tyre, sugjeron se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm.

2. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

Ambienti i jashtëm ekonomik dhe financiar shfaqet i përmirësuar. Aktiviteti ekonomik është zgjeruar dhe pritjet për ecurinë e tij janë pozitive. Tregjet financiare në Eurozonë janë stabilizuar pas efektit të 'Brexit' dhe treguesit financiarë kanë reflektuar divergjencat në kahun e politikës monetare të ndjekura nga bankat qendrore kryesore[2]. Perspektiva pozitive e Eurozonës rrethohet nga pasiguri të shtuara, të cilat lidhen kryesisht me zhvillimet politike të pritura këtë vit.

Ekonomitë e vendeve partnere tregtare rriten me terma pozitivë, por me ritme më të frenuara rritjeje. Çmimet e ulëta në tregjet ndërkombëtare janë përcjellë në presione të ulëta inflacioniste tek çmimet në rajon. Inflacioni në vendet e rajonit pritet të rritet në vitin në vazhdim, si pasojë e pritjeve për rritje të çmimeve të lëndëve të para dhe forcimit të rritjes ekonomike.

2.1. EKONOMIA BOTËRORE

Ekonomia botërore ka treguar ritme më të larta rritjeje në gjysmën e dytë të vitit 2016. Aktiviteti ekonomik paraqitet më i gjallëruar tek vendet e zhvilluara, por ritmet e rritjes janë përmirësuar edhe tek ato në zhvillim. Treguesit paraprakë sugjerojnë për vijim të kësaj ecurie edhe në pjesën e parë të vitit 2017. Treguesi

Grafik 2. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe Prodhimi Industrial* i vendeve kryesore (majtas) dhe inflacioni i vendeve kryesore** (djathtas)



*Prodhimi industrial është ndryshim mujor, ndërkohë që trendi afatgjatë i CLI është 100.
**Vendet e OBZHE (OECD) dhe Brazil, Kinë, Rusi, Indi dhe Afrikë e Jugut.
Burimi: OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik).

[2] *Në muajin qershor 2016, me anë të një referendumi popullor, Mbretëria e Bashkuar votoi për shkëputjen e vendit nga Bashkimi Evropian, gjë që krijoi tensione të përkohshme në tregjet financiare. Gjithashtu, FED ka nisur ciklin e rritjes së normës bazë të interesit, ndërsa BQE-ja ka konfirmuar zgjatjen e lehtësirave monetare në ekonomi, duke sjellë ndryshimin e kahut të normave të interesit për monedhën usd dhe euro.*

i përbërë botëror i prodhimit dhe i ekonomisë[3], si dhe treguesi paraprijës i PBB-së regjistruan rritje në muajt e fundit të vitit 2016, duke konfirmuar ecurinë pozitive të aktivitetit ekonomik. Presionet inflacioniste mbetën të ulëta, pjesërisht edhe si pasojë e efektit të çmimeve të naftës dhe të produkteve energjetike. Parashikimet për inflacionin tregojnë një rritje të tij gjatë vitit 2017, duke reflektuar rritjen e lehtë të çmimeve të naftës dhe produkteve të energjisë[4].

Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së		Norma e papunësisë		Norma e inflacionit
	tremujor	Vjetor			
	T3:2016	T3:2016	Nëntor-16	Dhjetor-16/ Nëntor-16	Dhjetor-16/ Dhjetor-15
ShBA	0.8	1.6	4.7*	0.3	2.1
Eurozonë	0.3	1.7	9.8	0.5	1.1
Gjermani	0.2	1.7	4.1	0.1	1.0
Francë	0.2	1.1	9.5	0.3	0.8
Mbretëri e Bashkuar	0.5	2.3	4.8†	0.5	1.6

Burimi: BQE, FED, Eurostat dhe Institutet statistikore përkatëse.
**Muaji dhjetor 2016; †Intervali shtator-nëntor 2016.*

Ekonomia e Eurozonës

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë u zgjerua në tremujorin e tretë të vitit, duke përshpejtuar lehtësisht normën vjetore të rritjes. Faktori kryesor në të cilin është mbështetur rritja ekonomike ka qenë gjallërimi i kërkesës së brendshme. Shpenzimet konsumatore kanë shfaqur një ecuri pozitive konstante, të ndikuar nga përmirësimi i tregut të punës. Lehtësimi i vazhdueshëm i politikës monetare dhe transmetimi i tij në tregjet financiare ka sjellë kushte më të favorshme financimi dhe është përkthyer në zgjerim të investimeve private, sidomos në sektorin e ndërtimit. Politika fiskale ka rezultuar stimuluese për Eurozonën në tërësi. Sektori i jashtëm ka shfaqur një kontribut në rënie në rritjen ekonomike, nën ndikimin e uljes së aktivitetit tregtar botëror. Inflacioni vijoi prirjen e tij rritëse të nisur në tremujorin e dytë të vitit, duke arritur vlerën vjetore prej 1.1% në muajin dhjetor. Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në vitin 2017, duke ndjekur shuarjen e efektit bazë të çmimeve të ulëta të ushqimit dhe energjisë në fillimin e vitit të kaluar. Në periudhën në vazhdim, politika lehtësuese monetare dhe rritja e fitimeve të korporatave, së bashku me përmirësimin e treguesit të prodhimit industrial dhe të tregut të punës, pritet të prodhojnë një rritje pozitive, por më të moderuar të aktivitetit ekonomik. Megjithatë, rreziqet ndaj këtyre pritshmërive qëndrojnë në kahun e poshtëm dhe burojnë nga situata politike në Evropë[5].

[3] *The global composite output PMI, Markit, tetor, nëntor dhe dhjetor 2016.*
[4] *Consensus Forecast, janar 2017.*
[5] *Në muajin mars 2017, Mbretëria e Bashkuar aktivizon nenin 50 të Traktatit të Lisbonës, akt i cili zyrtarizon fillimin e negociatave për shkëputjen e MB-së nga BE-ja. Gjithashtu, gjatë vitit 2017 do të ketë zgjedhje politike në disa shtete kryesore të Eurozonës: Francë, Gjermani, Holandë.*

Grafik 3. Indeksi i përbërë i prodhimit (PMI) dhe PBB-ja tremujore (majtas) dhe ecuria e treguesve të vrojtimit për biznesin, konsumatorët dhe ndjesinë ekonomike (djathtas)



Burimi: Markit, Eurostat, KE.

Në këndvështrimin gjeografik, Gjermania, Franca, Spanja dhe disa ekonomi periferike kanë qenë vendet që kanë mbështetur rritjen ekonomike të rajonit. Ekonomitë e vendeve kryesore partnere tregtare të Shqipërisë, Italia dhe Greqia, kanë shfaqur rritje pozitive në tremujorin e tretë të vitit 2016, pas një ecurie negative në tremujorin paraardhës. Ekonomia e Greqisë është rritur në sajë të shpenzimeve konsumatore dhe përmirësimit të aktivitetit tregtar, ndërsa kontributi i investimeve vijon të jetë negativ. Aktiviteti ekonomik në Itali është mbështetur nga shpenzimet konsumatore, investimet dhe shpenzimet qeveritare. Sektori financiar në Itali mbetet i brishtë, si pasojë e nivelit të lartë të kredive me probleme në një bankë kryesore të sistemit bankar. Inflacioni ka shënuar rritje në Greqi në muajin dhjetor, duke dalë nga territori negativ, por ai qëndron gjithsesi në vlera të ulëta. Edhe në Itali, inflacioni ka shënuar vlera të ulëta, por shfaq një tendencë rritëse në tremujorin e fundit të vitit.

Ekonomia e ShBA-së

Ekonomia e ShBA-së është përmirësuar edhe më tej në tremujorin e tretë të vitit 2016, duke shënuar norma rritjeje më të larta se në gjysmën e parë të tij. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është mbështetur nga përmirësimi si i kërkesës së huaj, ashtu edhe i asaj të brendshme. Rritja e fortë e eksporteve ka tejkaluar rritjen margjinale të importeve, duke sjellë një kontribut pozitiv të eksporteve neto në rritjen e prodhimit të brendshëm. Po ashtu, një kontribut i lartë ka ardhur nga investimet jorezidenciale. Kontributi i shpenzimeve konsumatore dhe ai i qeverisë qendrore, ndonëse pozitivë, kanë shfaqur shenja të lehta ngadalësimi. Tendenca pozitive e rritjes ekonomike pritet të vijojë edhe në tremujorin e katërt, si pasqyrues i konsolidimit të treguesve kryesorë ekonomikë.

Inflacioni ka vijuar të ndjekë një trajektore rritëse, të nisur që në mesin e vitit dhe arriti vlerën 2.1% në muajin dhjetor. Tregu i punës shfaq ecuri pozitive, ku norma e papunësisë qëndron në nivele të ulëta, nën 5%. Këto zhvillime, bashkë me një stimul fiskal më të lartë të pritur në vitin 2017, pritet të sjellin shtrëngim më të shpejtë të politikës monetare nga Rezerva Federale.

Ekonomitë e Rajonit[6]

Ekonomitë e rajonit, në përgjithësi, janë rritur në terma pozitivë në tremujorin e tretë të vitit, por duke treguar dinamika të ndryshme në zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Përjashtim nga ky trend ka shfaqur Turqia, ekonomia e së cilës është tkurrur në terma vjetorë. Në përgjithësi, shpenzimet konsumatore, investimet dhe kërkesa e jashtme kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të vendeve të rajonit.

Ekonomia e Turqisë ka treguar norma rritjeje vjetore negative në tremujorin e tretë të vitit, për herë të parë prej shtatë vitesh. Shpenzimet qeveritare kanë qenë i vetmi komponent që ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike, ndërsa situata politike në vend ka ndikuar negativisht në kërkesën e brendshme dhe të jashtme. Ekonomia e Maqedonisë ka ngadalësuar ritmin e rritjes në tremujorin e tretë të vitit. Mbështetësit e rritjes kanë qenë shpenzimet konsumatore dhe eksportet neto. Investimet janë tkurrur, duke pasqyruar ngërçin politik dhe mungesën e qeverisë në vend. Aktiviteti ekonomik në Kosovë është zgjeruar edhe në tremujorin e tretë të vitit, nën ndikimin e rritjes së shpejtë të shpenzimeve konsumatore dhe të investimeve. Shpenzimet qeveritare u tkurrën, e bashkë me ecurinë e eksporteve kanë zbutur rritjen ekonomike. Në Serbi, rritja ekonomike është përshpejtuar në tremujorin e tretë, duke pasqyruar rritjen dyshifrore të eksporteve dhe zgjerimin e investimeve. Shpenzimet konsumatore dhe ato qeveritare, ndonëse me rritje pozitive, kanë ngadalësuar ritmin e rritjes.

Normat e inflacionit në rajon vijojnë të jenë në nivele të ulëta, por ato shfaqin prirje rritëse në tremujorin e katërt. Në Kosovë e Serbi, inflacioni ka qëndruar në norma të ulëta, por pozitive, ndërsa në Maqedoni ai vijon të qëndrojë në territor negativ. Inflacioni në Turqi shënon vlera të larta, duke pasqyruar rritjen nominale të pagave në fillim të vitit 2016.

Për periudhën në vazhdim, rajoni pritet të shfaqë ritme më të larta të rritjes ekonomike. Inflacioni do të vijojë prirjen rritëse, ndikuar nga zbehja e efektit të çmimeve të ulëta të ushqimeve dhe naftës në tregjet botërore në vitin e kaluar, si dhe përmirësimi i aktivitetit ekonomik.

[6] *Vendet kryesore partnere tregtare në Ballkan, jo anëtare të BE-së.*

Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje

Vendet	Ndryshimi vjetor i PBB-së		Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë
	T2 - 2016	T3 - 2016	Dhjetor-2016	T3 - 2016
Itali	0.8	1.0	0.5	11.9*
Greqi	-0.9	1.8	0.3	23.0†
Maqedoni	3.1	2.4	-0.1	23.4
Serbi	1.9	2.6	1.6	13.8
Turqi	4.5	-1.8	8.5	11.4
Kroaci	2.0	2.7	0.7	11.4*
Kosovë	3.3	3.8	1.3	26.2**
Shqipëri	3.4	3.1	2.2	15.2

** Vlera për muajin nëntor 2016; †Vlera për muajin tetor 2016; **Vlera për T2 2016.*
Burimi: Institutet statistikore përkatëse.

2.2. ECURIA E ÇMIMEVE TË MALLRAVE KRYESORE NË TREGJET BOTËRORE

Çmimet e mallrave bazë kanë treguar rritje në tremujorin e fundit të vitit, duke ndjekur prirjen e nisur që në mesin e vitit 2016. Indeksi i mallrave kryesore (pa energjinë) ka shënuar rritje dyshifrore në muajt nëntor dhe dhjetor, duke reflektuar zbehjen e efektit bazë të çmimeve të ulëta të një viti më parë. Indeksi i çmimeve të ushqimit ka shfaqur një tendencë të ngjashme, duke treguar rritjen e kërkesës në ekonomitë në zhvillim. Brenda këtij grupi, çmimet e drithërave kanë qëndruar në të njëjtat nivele, pas ofertës së rritur tek prodhuesit e mëdhenj të këtyre prodhimeve bujqësore. Indeksi i çmimit të metaleve është rritur shpejt, duke treguar efektin e rritjes së kërkesës, si pasojë e zgjerimit të aktivitetit ekonomik botëror.

Çmimi i naftës Brent shënoi norma pozitive rritjeje në tremujorin e fundit të vitit, pas disa tremujorësh me rritje negative. Kjo dinamikë pason marrëveshjen ndërmjet vendeve prodhuese të OPEC dhe atyre jashtë OPEC për të tkurrur prodhimin botëror të naftës. Për periudhën pasuese, çmimi i naftës pritet të vijojë të ndjekë një prirje rritëse, të paktën deri në fund të vitit 2017.

Grafik 4. Ndryshimet vjetore të çmimeve të mallrave bazë



Burimi: EIA, FMN, llogaritje të autorëve.

Grafik 5. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed, BJ dhe BA).

2.3. TREGJET FINANCIARE

Rezerva Federale e ShBA-së rriti me 0.25 pikë përqindje normën bazë në muajin dhjetor, duke e sjellë atë në nivelin 0.50%-0.75%. Bankat e tjera qendrore kryesore i kanë lënë të pandryshuara normat e tyre bazë të interesit: Banka Qendrore Evropiane në 0.0%, Banka e Anglisë në 0.25% dhe Banka e Japonisë në -0.10%.

Interesat e instrumenteve në tregun e parasë në Eurozonë kanë vijuar të ulen. Normat e interesit libor për dollarin janë rritur, duke reflektuar rritjen e normës bazë nga ana e FED-it. Në tregjet e kapitaleve në ShBA, *yield*-et e obligacioneve afatgjata janë rritur, duke reflektuar kryesisht sinjalet e tkurrjes së lehtësimit monetar, efektet e rezultateve të zgjedhjeve, si edhe pritjet afatmesme të agjentëve për inflacionin. Në tregjet e kapitaleve në Eurozonë, rritjet e *yield*-eve të obligacioneve afatgjata kanë qenë të përmbajtura, duke reflektuar efektin e politikës monetare të BQE-së. Vendimet e mbledhjes së muajit dhjetor të BQE-së për ndjekjen e politikës lehtësuese deri në fund të vitit 2017 duket t'i kenë qetësuar agjentët e tregut financiar në Eurozonë. Diferenca e *yield*-eve për obligacionet qeveritare të shteteve periferike anëtare të Eurozonës me tituj me vlerësim maksimal është zgjeruar në tremujorin e fundit, duke reflektuar prime më të larta rreziku për këto vende.

Gjatë tremujorit të katërt, euro është nënçmuar ndaj dollarit amerikan, duke reflektuar zgjerimin e diferencave të normave të interesit midis Eurozonës dhe SHBA-së. Krahasuar me muajin shtator, në muajin dhjetor, euro u nënçmua me 6.0% ndaj dollarit amerikan.

Grafik 6. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters dhe Eurostat.

3. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE[7]

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016, zhvillimet në tregjet financiare kanë konfirmuar tendencat e vërejtura një tremujor më parë, ku kostot e fondeve të bankave dhe çmimi i kredisë mbi një vit vazhdon të ulet. Këto zhvillime reflektojnë tejçimin e plotë të sinjaleve të politikës monetare në tregjet financiare. Megjithatë, në tremujorin e katërt vihet re se ulja e interesave është frenuar krahasuar me një tremujor më parë, të ndikuar edhe nga rritja e yield-eve në tregun primar. Zhvillimet në tregun primar kanë demonstruar korrektimin e pritshëm të vlerave të tyre, si dhe zhbalancimin midis kërkesës dhe ofertës në këtë treg. Interesat në tregun e letrave me vlerë të qeverisë e mbyllën vitin në nivele të ngjashme me një vit më parë. Aktiviteti kreditues ka ndjekur sjelljen pozitive sezonale në muajt tetor-nëntor, duke mbetur në nivele të moderuara rritjeje. Zgjerimi i portofolit të kredisë është udhëhequr nga kreditimi në lekë dhe qëndrueshmëria e rritjes së kredisë për individë. Kushtet e kreditimit për biznese kanë vijuar të jenë të shtrënguara. Individët, krahas normave më të ulëta të interesit për kredinë, kanë përfituar edhe nga lehtësimi i kushteve joçmim të saj. Një ecuri e tillë e kredisë është reflektuar edhe në zgjerimin e moderuar të masës monetare. Këto zhvillime konfirmojnë se presionet nga sektori monetar mbi inflacion mbeten të ulëta.

3.1. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Tregu ndërbankar

Normat e interesit në tregun ndërbankar janë karakterizuar nga një ecuri e qëndrueshme. Presionet për likuiditet kanë qenë të përmbajtura, ndërkohë që kahu akomodues i politikës monetare i pandryshuar që prej muajit maj, ka favorizuar ruajtjen e niveleve të ulëta të interesave në treg. Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun e parasë, duke injektuar likuiditet nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes. Normat e interesit në tregun ndërbankar nuk kanë ndryshuar nga tremujori i mëparshëm. Interesat si për transaksionet javore dhe ato ditore qëndrojnë pranë normës bazë dhe ruajnë nivele të ulëta luhatshmërie[8] në linjë me objektivin operacional të politikës monetare. Ndërkohë, vëllimi i përgjithshëm i tregtuar nga bankat është rritur lehtë, por gjithsesi ka mbetur poshtë nivelit të tregtuar në gjysmën e parë të vitit. Profili i transaksioneve ndërbankare vijon të dominohet nga ato me afat njëjavor.

[7] *Analiza e zhvillimeve financiare dhe monetare bazohet në të dhënat financiare dhe monetare, të cilat që nga muaji shtator 2016 janë përpiluar sipas metodologjisë ESA2010. Për qëllime të analizës, zgjatja e serive është bërë me vlerësime statistikore.*

[8] *Devijimi standard i interesit ditor në tregun ndërbankar për këtë tremujor rezultoi 0.0752, nga 0.0598 në tremujorin e tretë.*

Grafik 7. Normat e interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe devijimi i tyre nga norma bazë (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka shtuar injektimin e likuiditetit në treg, në përgjigje të rritjes së kërkesës nga sistemi bankar. Krahas instrumentit kryesor, repos 7-ditore, në këtë periudhë janë përdorur edhe maturitetet 1- dhe 3-mujore. Normat e interesit në ankandet e kryera kanë qëndruar gjithmonë afër normës bazë.

Grafik 8. Operacionet e tregut të hapur të BSH (majtas) dhe vëllimi i tregtuar në tregun ndërbankar (djathtas), në miliardë lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregu i brendshëm valutor

Monedha vendase ka vazhduar të mbiçmohet kundrejt monedhave të partnerëve kryesorë tregtarë në tremujorin e katërt, por me ritëm më të ngadalësuar

krahasuar me një tremujor më parë. Kursi nominal efektiv i këmbimit, KNEK[9], është mbiçmuar rreth 3.2% në tremujorin e katërt përkundrejt një viti më parë. Për të njëjtën periudhë, kursi real efektiv i këmbimit KREK[10], u mbiçmua me 4.1%. Në këtë dinamikë, një rol të rëndësishëm ka zënë dhe mbiçmimi i lekut ndaj lirës turke dhe renminbit kinez, duke transmetuar në mënyrë indirekte zhvlerësimin e tyre të fortë ndaj dollarit amerikan. Korrektuar për këtë efekt, mbiçmimet vjetore në indekset e kompozuara, KNEK dhe KREK sipas peshave tregtare, do të ishin më të moderuara, përkatësisht 1.1% dhe 2%.

Grafik 9. Ecuria e kursit të këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e kursit dypalësh të lekut sipas monedhave kryesore ka shfaqur pothuajse të njëjtën panoramë. Kështu, kursi lek/euro ka qenë në një tendencë të vazhdueshme mbiçmuese, duke kulmuar në ditët e fundit të muajit dhjetor në nivelin 134.4, më i ulëti në pesë vitet e fundit. Kjo ecuri është ndikuar nga një ofertë e lartë për euron e krijuar nga flukset tregtare[11], nga prurjet e emigrantëve për festat e fundvitit dhe nga projektet e mëdha të investimeve të huaja. Nivelet e ulëta të kursit të këmbimit nxitën një kërkesë të shtuar për euro, e cila u akomodua nga oferta e lartë. Në terma mesatarë tremujorë, mbiçmimi prej 0.4% i lekut ndaj euros shfaqet ndjeshëm më i zbutur se sezonaliteti i muajve të verës (1% mbiçmim në tremujorin e tretë).

[9] *Kursi nominal efektiv i këmbimit (KNEK/NEER) llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë (Itali, Greqi, Gjermani, Turqi dhe Kinë), duke përdorur peshat përkatëse në tregti. Me qëllim përllogaritjen e kursit lira/lek dhe renminbi/lek, kursi zyrtar referues mbetet ai i lirës turke dhe i renminbit kinez ndaj dollarit amerikan.*

[10] *Kursi real efektiv i këmbimit (KREK/REER) llogaritet në mënyrë të ngjashme si ai nominal, por merr parasysh edhe inflacionin në vend dhe në partnerët tregtarë.*

[11] *Sipas të dhënave tregtare, në muajin dhjetor vihet re një rritje mjaft e lartë vjetore (22.5%) e eksporteve të mallrave, kryesisht nga rritja e eksportit të mineraleve dhe metaleve. Importet nga ana tjetër janë rritur me rreth 4.4%. Për rrjedhojë, deficiti tregtar është ngushtuar me 4.7%.*

Një ecuri të kundërt nga sa më sipër ka shfaqur kursi lek/usd në tremujorin e katërt. Monedha e gjelbër u këmbye mesatarisht me 126 lek/usd gjatë këtij tremujori, përkundrejt nivelit mesatar prej 122 lek/usd në tremujorin e tretë. Nënçmimi prej 2.8% i lekut ndaj dollarit amerikan gjatë tremujorit të katërt reflektoi më së shumti forcimin e këtij të fundit ndaj euros në tregjet ndërkombëtare. Rritja e normës bazë së interesit të FED-it, e shoqëruar me pritjet për forcimin e këtij trendi në të ardhmen përkundrejt lehtësimit të mëtejshëm të politikës monetare të BQE-së dhe pritjeve për vijimin e kësaj tendence, u reflektuan në forcimin e dollarit ndaj euros në tregjet ndërkombëtare[12].

Tregu primar

Yield-et e bonove dhe të obligacioneve të thesarit kanë vijuar të rriten edhe në tremujorin e fundit, duke konfirmuar tendencën e vërejtur në tremujorin e tretë. Rritja e *yield*-eve ka qenë e përgjithshme, çka është reflektuar në rritje të nivelit dhe të pjerrësisë së kurbës së *yield*-eve. Rritja e *yield*-eve ka reflektuar korrektimin e rënies së shpejtë të *yield*-eve në pjesën e parë të vitit, kërkesën e rritur për financim nga qeveria dhe shtrëngimin e ofertës së sistemit bankar në ankande.

Grafik 10. *Yield*-et në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Yield-i 12-mujor i bonove të thesarit u rrit në mesatarisht 3.02% në muajin dhjetor, kundrejt nivelit 1.60% të shënuar në fund të muajit shtator. Në ankandin e fundit të muajit, ai regjistroi nivelin 3.22%. Ecuri të njëjtë kanë treguar edhe *yield*-et e obligacioneve, të cilat kanë regjistruar rritje të njëpasnjëshme në çdo ankand. Kërkesa e bankave në ankande ka rezultuar shpesh poshtë emetimeve, duke shtuar presionet për rritje të *yield*-eve të kërkuara. *Yield*-i i obligacionit

[12] *Në muajin dhjetor, kursi euro/usd në tregjet ndërkombëtare shënoi mesatarisht 1.05 ose 5.6% nënçmim të euros përkundrejt mesatares së tremujorit të tretë.*

2-vjeçar u ngjit në 3.60% në muajin dhjetor, nga 2.00% në muajin shtator. Në ankandet e obligacioneve 5- dhe 7-vjeçare, *yield*-et respektive regjistruan rritje me afërsisht 1.0 pikë përqindje nga ankandet paraardhëse, duke u ngjitur në 5.25% dhe 5.98%. Në fund të muajit nëntor, Ministria e Financave zhvilloi edhe një ankand për emetimin e obligacioneve 2-vjeçare në euro. Kërkesa e bankave për të investuar ishte e lartë dhe për rrjedhojë interesi mesatar prej 0.75% ishte ndjeshëm më i ulët se norma prej 3.23% e vendosur në ankandin e zhvilluar një vit më parë.

3.2. NORMAT E INTERESIT TË DEPOZITAVE DHE KREDIVE DHE KUSHTET E FINANCIMIT[13]

Normat e interesit për **depozitat e reja në lekë** në periudhën tetor–nëntor kanë rezultuar afërsisht në të njëjtin nivel me tremujorin e tretë. Norma mesatare e interesit rezultoi 0.82%, nga 0.81% që shënonte në tremujorin e tretë. Në muajin nëntor, interesat e depozitave janë ulur tek maturitetet 3- dhe 24- mujore dhe kanë shënuar rritje tek maturiteti 1- dhe 6-mujor. Interesi i depozitave 12-mujore, të cilat zënë peshën kryesore në depozitat me afat, nuk ka ndryshuar në këto dy muaj, duke rezultuar 0.69%. Normat e interesit për **depozitat e reja në euro** kanë paraqitur ecuri të ngjashme me ato në lekë. Interesi mesatar i dy muajve të fundit (tetor dhe nëntor) është i afërt me tremujorin e tretë. Pasi u rrit në 0.19% në muajin gusht, norma mesatare shënoi vlerën 0.16% në tre muajt pasues. Ashtu si edhe tek depozitat në lekë, interesi i depozitave 12-mujore ka qëndruar në nivele të ulëta këto muaj.

Grafik 11. Normat e interesit për depozitat e reja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[13] *Të dhënat më të fundit zyrtare për normat e interesit për kreditë dhe depozitat e reja i përkasin muajit gusht 2016.*

Interesat për **kredinë e re në lekë** kanë treguar prirje të lehta rritëse në muajt tetor dhe nëntor, të ndikuar nga rritja e tyre në segmentin afatshkurtër. Nga ana tjetër, norma e interesit për kredinë mbi një vit ka vijuar të ulet këta dy muaj. Norma mesatare e përgjithshme e interesit në muajt tetor-nëntor rezultoi respektivisht 8.21% dhe 7.64%[14]. Në segmentin e bizneseve, normat e interesit janë ulur për kreditë për investime dhe janë rritur për kredinë për mbështetje me likuiditet. Në segmentin e individëve, normat e interesit janë ulur lehtë për financimin e konsumit, ndërkohë që nuk kanë ndryshuar për kreditë hipotekare. Norma mesatare e kredisë për individë rezultoi lehtësisht më e ulët se në tremujorin e tretë të vitit dhe 1.89 pikë përqindje më e ulët se një vit më parë.

Grafik 12. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma mesatarë, normat e interesit për **kreditë e reja në euro** rezultuan në të njëjtat nivele me tremujorin e kaluar. Ato janë ulur për kreditë për investime dhe janë rritur në të njëjtën masë për kreditë për likuiditet, duke lënë të pandryshuar normën mesatare të interesit për biznese. Interesat në euro për individët janë rritur lehtas për kredinë hipotekare, ndërsa nuk kanë ndryshuar për kreditë konsumatore. Diferenca e normës mesatare të kredisë në lekë kundrejt asaj në euro është ulur lehtësisht krahasuar me tremujorin e tretë të vitit.

Vrojtimi i aktivitetit të kredisë në tremujorin e katërt tregon se bankat kanë vazhduar të ndjekin politika konservatore për kreditimin e bizneseve nëpërmjet elementeve joçmim të kredisë. Të para sipas madhësisë së biznesit, bankat shprehen se kanë shtrënguar më tej kushtet e kreditimit për biznesin e madh, ndërsa kanë ruajtur të pandryshuara ato për biznesin e mesëm dhe të vogël. Shtrëngimi i kushteve të kreditimit është shprehur në rritjen e kërkesave për kolateral, ndërsa kushtet për elementet e tjera joçmim kanë mbetur pothuajse të pandryshuara.

[14] *Mesatarja e tremujorit të tretë rezultoi 7.52%.*

Bankat shprehen se kanë vazhduar të lehtësojnë standardet e kreditimit për individët, veçanërisht për kredinë konsumatore. Si instrumente kryesore për lehtësimin e kushteve për individët në tremujorin e katërt, bankat kanë përdorur zgjatjen e maturitetit të kredisë, uljen e raportit të mbulimit të kështit me të ardhurat dhe uljen e komisioneve.

Grafik 13. Kushtet e kreditimit (për biznese majtas, për individë djathtas)



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues, Banka e Shqipërisë.

3.3. KREDITIMI I SEKTORIT PRIVAT[15]

Aktiviteti kreditues është rritur me ritme të moderuara në tremujorin e fundit të vitit 2016. Në muajt tetor-nëntor, **kredia për sektorin privat** është rritur mesatarisht me 3.2% vit mbi vit, normë kjo e ngjashme me tremujorin paraardhës. Megjithatë,

Grafik 14. Ecuria e kredisë për sektorin privat



* Grafiku djathtas bazohet në rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues të tremujorit të katërt 2016.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[15] *Analiza e kredisë bazohet në të dhënat monetare të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci. Totali i kredive të nxjerra nga bilanci në 11 muajt e parë të vitit është rreth 9 miliardë lekë.*

flukset neto mujore janë më të larta se në tremujorin e tretë, në linjë dhe me sjelljen sezonale të këtyre dy muajve. Gjatë kësaj periudhe, stoku i kredisë për sektorin privat u rrit me rreth 5.3 miliardë lekë, i ndikuar më së shumti nga zgjerimi i muajit nëntor. Në raport me PBB-në, kredia për sektorin privat vlerësohet rreth 37.4%, nivel ky lehtësisht më i lartë sesa fundi i një viti më parë. Rigjallërimi i aktivitetit ekonomik dhe përmirësimi i besimit të agjentëve ekonomikë është reflektuar në rritje të kërkesës për kredi, por ende nuk është shfaqur në rimëkëmbje të aktivitetit kreditues si pasojë e ofertës akoma të shtrënguar.

Ecuria pozitive e portofolit të kredisë është nxitur nga **kreditimi në monedhën vendase**. Norma vjetore e rritjes së këtij portofoli u përshpejtua në 10.4%, përkundrejt 7.5% në tremujorin e tretë. Kjo rritje ka kompensuar edhe tkurrjen vjetore të portofolit në valutë (-1.4%). Në fund të muajit nëntor, kredia në lekë zë rreth 43.2% të portofolit të kredisë, me një rritje prej 2.5 pikësh përqindjeje përgjatë vitit. Këto zhvillime janë përkrahur nga rënia e kostos së financimit për huamarrjen në lekë prej më shumë se dy vitesh, si dhe nga ndërgjegjësimi i agjentëve ekonomikë për rrezikun e kursit të këmbimit.

Sipas agjentëve ekonomikë, zgjerimi i kredisë është mbështetur nga ritmet e larta të rritjes së **kredisë për individë**. Në muajt tetor- nëntor, **kredia për individë** u rrit mesatarisht me 5.1%, krahasuar me mesataren prej 3.7% në tremujorin e kaluar. Përmirësimi i kushteve në tregun e punës, forcimi i besimit dhe rritja e të ardhurave të disponueshme, kanë favorizuar rritjen e kërkesës për kredi. Për më tepër, lehtësimi i vazhdueshëm i kushteve të kreditimit nga bankat për këtë segment ka përkrahur zhvillimet pozitive në kreditim. Portofoli i kredisë për individë ka reflektuar performancën e mirë të kredisë konsumatore, e cila shënoi një rritje vjetore prej 11.4%. Ndërkohë, kredia për banesa ka shfaqur ecuri të ngadaltë. Normat vjetore të rritjes së saj zbritën në 3.3%, krahasuar me 3.6% në tremujorin e tretë. Struktura e këtij portofoli është zhvendosur drejt kreditimit në lekë përgjatë vitit.

Grafik 15. Ecuria e kredisë për individë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Ecuria e kredisë për biznese



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kreditimi i bizneseve vijon të jetë i brishtë, i ndikuar si nga një ofertë e ngurtë/konservatore, ashtu edhe nga rikuperimi i ngadaltë i kërkesës për kredi. Norma prej 2.6% e rritjes vjetore të këtij portofoli në muajin nëntor qëndron më poshtë se ajo e dy tremujorëve paraardhës. Gjithsesi, krahasuar me zhvillimet në tremujorin e tretë, në muajt tetor- nëntor vihet re një përmirësim i dinamikës mujore së kredisë për biznese, e mbështetur nga kredia për investime. Në muajin nëntor, ritmet vjetore të rritjes së këtij portofoli shënuan përmirësim në 2.5%. Kredia për likuiditet ngadalësoi ritmet e rritjes vjetore në 2.8%, përkundrejt 3.5% të shënuar në tremujorin paraardhës. Rimëkëmbja e ngadaltë e kredisë për bizneset është diktuar nga kushte të shtrënguara kreditimi, veçanërisht për biznesin e madh, i cili ka dhe peshën më të madhe në portofol dhe nga rikuperimi i ngadaltë i kërkesës për financim nga klientët cilësorë. Niveli i lartë i kredive me probleme mbetet një nga shqetësimet kryesore të bankave dhe kushtëzon një ofertë të ngurtë për kredi në segmentin e bizneseve.

3.4. FINANCIMI I SEKTORIT PUBLIK

Politika fiskale konsoliduese e ndjekur gjatë 11 muajve të parë të vitit 2016 është reflektuar në një suficit fiskal prej 7.1 miliardë lekësh. Pavarësisht vlerave pozitive për balancën buxhetore, huamarrja në tregun e brendshëm dhe atë të huaj ka vijuar përgjatë 11-mujorit. Këto zhvillime janë materializuar në vlera të larta të likuiditetit të qeverisë.

Sikurse edhe gjatë 9 muajve të parë të vitit 2016, politika e huamarrjes së qeverisë gjatë muajve tetor

Grafik 17. Deficiti buxhetor dhe instrumentet e financimit të tij, në miliardë lekë (kumulative)



Burimi: Ministria e Financave.

e nëntor ka qenë e orientuar drejt instrumenteve afatgjata (obligacione 5-, 7- dhe 10-vjeçare). Huamarrja e brendshme rezultoi 5.6 miliardë lekë. Ajo u formua tërësisht nga instrumentet afatgjata, (duke kompensuar edhe reduktimin me 14.3 miliardë lekë të portofolit të bonove të thesarit), duke i shërbyer në këtë mënyrë zgjatjes së maturitetit të borxhit të brendshëm. Huamarrja e huaj neto në fund të muajit nëntor 2016 rezultoi rreth 14.7 miliardë lekë.

3.5. ECURIA E DEPOZITAVE DHE E PARASË NË EKONOMI

Ecuria e ofertës monetare në ekonomi ka shënuar përmirësim në muajt tetor-nëntor. Treguesi i parasë së gjerë, agregati M3, shënoi rritje mesatare me rreth 2.8% në terma vjetorë, kundrejt rritjes prej 2% në tremujorin e tretë të vitit. Mjetet valutore neto të sistemit bankar mbeten kontribuuesi kryesor në rritjen e parasë së gjerë, pavarësisht se në një masë më të ulët krahasuar me tremujorin paraardhës. Zgjerimi i masës monetare është mbështetur gjithashtu edhe nga përmirësimi i kontributit të huamarrjes së sektorit publik në krijimin e parasë. Agregati monetar në lekë, M2, ka zbutur gradualisht normat rënëse, ku këto të fundit janë ndikuar kryesisht nga politika fiskale konsoliduese e ndjekur përgjatë vitit 2016. Në muajin nëntor, agregati M2 ka shënuar rritje me rreth 0.1% në terma vjetorë. Treguesi i parasë likuide, agregati M1, ka shënuar norma vjetore në rritje, mesatarisht 11.3% në muajt tetor-nëntor, duke reflektuar rritjen e shpejtë të depozitave pa afat. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj agregatit M2, i korrektuar për zhvendosjet në instrumente të tjera jashtë M2, ka mbetur i pandryshuar nga fundi i tremujorit të tretë, në 26.5%.

Grafik 18. Ecuria e treguesve monetarë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ritmi i rritjes së depozitave në sistemin bankar ka vijuar të përmirësohet gradualisht[16]. Në fund të muajit nëntor, stoku total i depozitave rezulton rreth 4.5% më i lartë se një vit më parë, kundrejt normës vjetore prej 3.8% në fund

[16] *Në depozitat totale përfshihen edhe depozitat me maturitet mbi dy vjet që nuk janë pjesë e llogaritjes së agregatit M3.*

të tremujorit të tretë. Raporti i depozitave në total ndaj PBB-së vlerësohet të jetë rreth 72.7% në muajin nëntor. Zgjerimi i depozitave ka marrë kryesisht formën e depozitave në valutë, të cilat janë rritur mesatarisht me 7.7% vit mbi vit në periudhën tetor-nëntor. Depozitat në lekë janë zgjeruar me ritme më të moderuara, duke shënuar rritje mesatare prej 1.1% për të njëjtën periudhë. Ecuria e depozitave sipas agjentëve ekonomikë konfirmon rritje të qëndrueshme të depozitave të individëve (2.6%), ndërsa vërehet zgjerim më i shpejtë i depozitave të bizneseve (14.7%), kryesisht në valutë.

Grafik 19. Ecuria e depozitave ndaj PBB dhe sipas monedhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e depozitave ka vijuar të zhvendoset drejt depozitave pa afat, të cilat në muajin nëntor përbëjnë rreth 38.7% të stokut total, krahasuar me peshën e tyre prej 33.4% në fund të vitit të kaluar. Zhvendosje janë vënë re edhe drejt depozitave me afat maturimi mbi dy vjet, por në një masë më të ulët. Në terma absolutë mujorë, depozitat u zgjeruan me rreth 9.4 miliardë lekë gjithsej në muajt tetor-nëntor, nga të cilat rreth 7.5 miliardë lekë rezultuan depozita në valutë.

Grafik 20. Ecuria e depozitave sipas maturiteteve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE

Inflacioni mesatar vjetor shënoi vlerën 1.9% në tremujorin e katërt të vitit 2016, duke mbetur në nivel të ngjashëm me atë të tremujorit të kaluar. Këto zhvillime kanë reflektuar forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste, si pasojë e përmirësimit të kërkesës agregate dhe të pozicionit ciklik të ekonomisë, por edhe dobësimin e presioneve të huaja dezinflacioniste.

Rritja ekonomike e tremujorit të tretë rezultoi rreth 3.1%, e ndikuar kryesisht nga rritja e investimeve dhe e eksporteve neto. Kontribute janë gjeneruar edhe nga konsumi i popullatës dhe konsumi publik. Të dhënat e disponuara sugjerojnë se rritja ekonomike do të përshpejtohet lehtësisht gjatë tremujorit të katërt, e nxitur si nga kërkesa e brendshme ashtu edhe nga eksportet neto.

Përshpejtimi i rritjes ekonomike në afatin e mesëm do të ndihmojë në kthimin e ekonomisë në ekuilibër, duke u shoqëruar me rritje graduale të presioneve të brendshme inflacioniste. Presionet e jashtme inflacioniste pritet të mbeten të dobëta, por më të qenësishme se më parë. Pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin parashikohet të ndjekin trend rritës, duke tentuar gradualisht afrimin në objektiv. Këta faktorë do të ndihmojnë kthimin e inflacionit në objektiv brenda horizontit afatmesëm.

4.1. ECURIA E INFLACIONIT

Inflacioni mesatar rezultoi 1.85% në tremujorin e katërt të vitit 2016, duke mbetur pothuajse në të njëjtat vlera si edhe në tremujorin e mëparshëm. Norma

Grafik 21. Inflacioni vjetor dhe objektivi (majtas).
Inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

e inflacionit pësoi rënie në muajin tetor, por ajo u rrit përsëri në dy muajt pasues të tremujorit, duke shënuar, në muajin dhjetor, vlerën më të lartë të tij në vitin 2016, prej 2.2%. Prirja rritëse e inflacionit gjatë pjesës së dytë të vitit rezultoi në linjë me parashikimet dhe, në profil, e ngjashme me inflacionin e vendeve të rajonit dhe më gjerë.

Inflacioni vjetor në tremujorin e katërt është formuar kryesisht nga kontributi i kategorive "Ushqime" dhe "Mallra konsumi joushqimor", ndërkohë që kategoritë e tjera kanë dhënë një kontribut shumë të ulët. Në veçanti, në kahun rritës ka qenë inflacioni i kategorisë "Ushqime të përpunuara" dhe ai i kategorisë "Mallra konsumi joushqimor". Gjatë tremujorit të fundit të vitit, nuk janë vënë re kontribute negative të ndonjë kategorie te inflacioni total, sjellje që ka konsoliduar prirjen rritëse të tij.

Grupi i mallrave ushqimore kontribuoi me rreth 80% në formimin e inflacionit total. Kategoria "Ushqime të papërpunuara" u karakterizua, si zakonisht, nga norma të larta të inflacionit mujor me rastin e festave të fundvitit. Megjithatë, efekti sezonal i muajit dhjetor pati intensitet të lartë në rritje krahasuar me mesataren e tij ndër vite. Kjo kategori kontribuoi mesatarisht me 0.9 pikë përqindje në inflacionin total.

Grafik 22. Kontributet sipas kategorive ushqimore dhe joushqimore në inflacionin vjetor total



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Kategoria "Ushqime të përpunuara" dha një kontribut prej 0.6 pikësh përqindjeje në inflacionin total. Gjatë këtij viti, inflacioni i këtyre produkteve ka pësuar rritje të vazhdueshme në nivel mujor, por ky efekt u shfaq me intensitet më të lartë në dy muajt e fundit të vitit. Kontributi suplementar i kësaj kategorie te norma totale e inflacionit përgjatë periudhës nëntor-dhjetor ka qenë rreth 1 pikë përqindjeje më i lartë krahasuar me tremujorin e parë të vitit. Më të spikatura kanë qenë rritjet në grupin "Bukë dhe drithëra", i cili ka dhe peshën më të lartë brenda kësaj kategorie.

Kategoria "Mallra të konsumit joushqimor" kontribuoi me 0.3 pikë përqindje te norma e inflacionit total. Ky kontribut ishte 0.4 pikë përqindje më i lartë se një tremujor më parë. Pas një periudhe të gjatë kohore me kontribut negativ (dhjetor '14 – gusht '16), kjo kategori shënoi një vlerë pozitive në muajin shtator e në vazhdim. Ky zhvillim ka ardhur kryesisht si rezultat i bazës së ulët krahasuese të vitit të kaluar kundrejt një rritjeje të çmimeve të naftës në tregun vendas. Ndërkohë, luhatje kanë demonstruar edhe çmimet e disa mallrave të veçanta të kësaj kategorie[17].

[17] *Brenda kësaj kategorie, luhatje të ndjeshme ka pësuar indeksi i çmimeve të mallit "dru zjarri", i cili në muajin nëntor pësoi një rritje të pazakontë pasuar nga një rënie në muajin dhjetor.*

*Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)**

	T4:14	T1:15	T2:15	T3:15	T4:15	T1:16	T2:16	T3:16	T4:16
Ushqime të përpunuara (pp)	0.2	0.3	0.2	0.1	0.0	-0.4	0.1	0.4	0.6
Bukë dhe drithëra (pp)	-0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	-0.2	-0.1	0.0	0.1
Alkool dhe duhan (pp)	0.3	0.3	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
Ushqime të papërpunuara (pp)	0.8	1.7	1.8	1.8	2.6	1.5	0.9	1.2	0.9
Fruta (pp)	0.4	0.5	0.8	0.8	0.9	0.7	0.6	0.4	0.2
Perime(pp)	0.2	1.1	0.9	0.9	1.7	0.8	0.3	0.8	0.6
Shërbime (pp)	0.2	0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.2	0.0
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.1	0.1	0.1
Strehim (pp)	0.1	0.1	-0.1	0.0	-0.2	-0.2	0.0	0.0	0.0
Mallra konsumi joushqimorë	0.0	-0.4	-0.2	-0.2	-0.3	-0.3	-0.3	-0.1	0.3
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
Indeksi i çmimeve të konsumit (ndryshim vjetor %)	1.3	1.9	1.8	1.8	2.1	0.7	0.7	1.9	1.9

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

Gjallërimi i rritjes ekonomike gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2016, i mbështetur nga përçimi i politikës monetare akomoduese, konfirmoi vlerësimet tona për shtim të presioneve inflacioniste gjatë tremujorit të katërt të vitit. Efektet e faktorëve të mësipërm pritet të shtrijnë ndikimin e tyre në inflacion edhe përgjatë periudhave të ardhshme, në sajë të dinamikave rritëse të konsumit dhe të investimeve private. Nga krahu i ofertës, këto zhvillime pritet të pasqyrohen në: shfrytëzimin më të lartë të kapaciteteve të lira të punës dhe të kapitalit; pritje më optimiste të agjentëve të tregut për aktivitetin ekonomik; zbutjen e pasigurive ekonomike; dhe në vijimin e prirjes rritëse të inflacionit drejt objektivit.

4.2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Sipas të dhënave të INSTAT-it, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) rezultoi me një rritje reale vjetore prej 3.1% në tremujorin e tretë të vitit 2016. Norma e rritjes ka rezultuar lehtësisht më e ulët krahasuar me tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2016 [18].

Në terma sektorialë, kontributet kryesore pozitive janë dhënë nga sektori i shërbimeve. Sektori prodhues dha gjithashtu një kontribut pozitiv, i mbështetur nga ndërtimi dhe bujqësia. Në terma të kërkesës agregate, kontributet më të larta janë shënuar nga formimi bruto i kapitalit fiks dhe nga eksportet neto. Ndërkohë, kontribute suplementare pozitive kanë buruar nga konsumi i popullatës dhe konsumi publik.

Sipas INSTAT-it, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 3.1% dhe 0.9%, respektivisht në nivel vjetor e tremujor, në tremujorin e tretë të vitit 2016. Norma vjetore e rritjes rezultoi lehtësisht më e ulët krahasuar me tremujorin e kaluar (3.4%). Sektori i shërbimeve dha kontributin kryesor pozitiv në rritjen e PBB-së.

[18] *Kjo është ndikuar edhe nga rishikimi i serive kohore të llogarive kombëtare në vitet e mëparshme.*

Gjithashtu, kontribute pozitive kanë buruar edhe nga sektori i ndërtimit dhe, lehtësisht, nga sektori bujqësor. Nga ana tjetër, industria ka shfaqur tkurrje në terma vjetorë. Normat negative të rritjes kanë karakterizuar si industrinë nxjerrëse ashtu edhe atë përpunuese.

Analiza e komponentëve të kërkesës tregon për kontribut të mëtejshëm pozitiv nga kërkesa e brendshme. Ky kontribut ka ardhur kryesisht nga rritja e investimeve dhe më pak nga rritja e konsumit. Ndërkohë, eksportet neto kanë shfaqur një kontribut të lartë në rritjen ekonomike në ndryshim nga tremujorët e mëparshëm. Ecuria e mirë e eksportit të shërbimeve ka qenë faktori kryesor në këtë dinamikë.

Grafik 23. Ecuria vjetore dhe tremujore e PBB-së



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Informacioni i disponuar për tremujorin e katërt të vitit tregon për vijimësinë e normave pozitive të rritjes ekonomike, me një dinamikë më të fortë krahasuar me tremujorët e mëparshëm. Kërkesa e brendshme pritet të ruajë normat e rritjes, me kontribute pozitive nga të gjithë komponentët përbërës, por kryesisht nga formimi i kapitalit. Gjithashtu, ndikimet nga konsumi privat dhe konsumi publik pritet të mbështesin rritjen reale. Kontributi i eksporteve neto parashikohet të jetë pozitiv, sikurse në tremujorin e tretë të vitit. Eksportet e shërbimeve pritet të ruajnë normat e rritjes vjetore, njëkohësisht kur statistikat e tregtisë së jashtme dëshmojnë për një përshpejtim të eksportit të mallrave gjatë tremujorit të katërt të vitit.

4.2.1. PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE[19]

Ecuria ekonomike e tremujorit të tretë të vitit 2016 vijoi të mbështetet në masën më të madhe nga zhvillimet pozitive në **sektorin e shërbimeve**. Vlera e shtuar e sektorit, me gjithë ngadalësimin e dinamikës rritëse, llogaritet të ketë kontribuar me 2.0 pikë përqindje në rritjen vjetore të PBB-së. Gjithashtu, performanca më e përmirësuar e **sektorit prodhues** ndikoi lehtësisht, me rreth 0.7 pikë përqindje, në rritjen ekonomike. Kjo ecuri i atribuohet kryesisht zgjerimit të aktivitetit ndërtues dhe ritmit pozitiv të shfaqur nga aktivitetet e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, kontributet e të cilëve llogariten përkatësisht 0.8 dhe 0.2 pikë përqindje në rritjen e PBB-së. Ndërkohë, tkurrja e vlerës së shtuar të industrisë dha një kontribut negativ prej 0.3 pikë përqindje. Komponenti i **taksave neto** vazhdoi të gjenerojë një kontribut pozitiv për rritjen ekonomike, në rreth 0.4 pikë përqindje nga 0.5 pikë përqindje një tremujor më parë[20].

[19] *Ecuria e PBB-së dhe e vlerës së shtuar bruto sipas sektorëve trajtohet në terma të ndryshimeve vjetore reale. Analiza mbështetet në të dhënat më të fundit të PBB-së sipas metodës së prodhimit për tremujorin e tretë të vitit 2016 të publikuara nga INSTAT në datën 12 janar të vitit 2017. Diferencat midis normave të rritjes së sektorëve të këtij publikimi dhe atyre të analizuara në Raportin e mëparshëm Tremujor të Politikës Monetare janë rezultat i rishikimit të serive.*

[20] *Komponenti i taksave neto vazhdon të ndikohet kryesisht nga zëri i taksave mbi produktet, kontributi i të cilit llogaritet rreth 0.3 pikë përqindje për rritjen ekonomike.*

Grafik 24. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit



*Të dhënat janë paraprake. **Një vlerësim i parë.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Vlera e shtuar nga **sektori i shërbimeve** shënoi rritje vjetore me 4.1% në tremujorin e tretë të vitit 2016, një ritëm ky më i ngadaltë krahasuar me zgjerimin e shënuar në dy tremujorët e parë të vitit (përkatësisht 4.9% dhe 5.8%). Megjithatë, ecuria e sektorit vijon të qëndrojë mbi normën mesatare historike të rritjes 3%, e mbështetur në masën më të madhe nga dega **"Tregti, hotele e restorante dhe transport"** me 2.3 pikë përqindje. Aktiviteti i kësaj dege vazhdoi të ndjekë prirje rritëse, duke regjistruar zgjerim të vlerës së shtuar me 6.7% në terma vjetorë.

Degët e **"Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit"** dhe **"Shërbimeve të tjera"** shfaqën dinamika më të forta rritjeje në terma të vlerës së shtuar në tremujorin në analizë, duke kontribuar me përkatësisht 0.9 dhe 0.6 pikë përqindje në rritjen vjetore të sektorit të shërbimeve. Vlera e shtuar e aktiviteteve të lidhura me **"Pasuritë e paluajtshme"** dhe me **"Administratën publike, arsimin dhe**

Grafik 25. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

shëndetësinë" shënoi norma të ulëta rritjeje vjetore (respektivisht 1.5% dhe 1.2%), të përkthyera përkatësisht në kontributet 0.2 dhe 0.3 pikë përqindje për ecurinë e shërbimeve. Ndërkohë, tkurrja e lehtë e vlerës së shtuar të degëve të **"Aktiviteteve profesionale dhe shërbimeve administrative"** dhe **"Informacionit dhe komunikacionit"**, ndikoi ecurinë e vlerës së shtuar të sektorit, duke kontribuar negativisht me 0.2 pikë përqindje.

Rritja e ndjeshme e treguesit të besimit dhe e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve në aktivitetet e shërbimeve pa tregtinë japin sinjale pozitive mbi zhvillimet në sektorin e shërbimeve në tremujorin e katërt të vitit 2016.

Grafik 26. Ecuria e vlerës së shtuar në ndërtim dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Performanca e **sektorit të ndërtimit** rezultoi sërish më e gjallëruar në tremujorin e tretë të vitit 2016, pas një tendence ngadalësimi të normave të rritjes gjatë katër tremujorëve të mëparshëm. Vlera e shtuar e sektorit u zgjerua me 8.3% në terma vjetorë, një normë kjo më e lartë se rritja vjetore me 1.8% në tremujorin e mëparshëm[21]. Dinamika pozitive e komponentit publik[22] dhe rritja e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte vlerësohet të kenë mbështetur ecurinë e sektorit në kahun rritës. Ndërkohë, vlerat e përafërta të lejeve të ndërtimit u zgjeruan në terma vjetorë, duke pasqyruar rritje në të gjitha kategoritë e ndërtimeve: **punime inxhinierike, ndërtime për qëllime banimi dhe ndërtesa të tjera**[23].

[21] *Në një linjë me këtë ecuri të sektorit rezulton edhe dinamika e shifrës së afarizmit në vëllim dhe e indeksit të vëllimit të prodhimit, të cilët përshpejtuan ritmet e rritjes vjetore në përkatësisht 5.7% dhe 7.9% në tremujorin e tretë të vitit 2016, nga 2.9% dhe 1.0% të shënuar një tremujor më parë.*

[22] *Siç sugjerohet nga rritja e shpenzimeve kapitale buxhetore gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016.*

[23] *Rritja e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit në kategorinë e punimeve inxhinierike (ku përfshihen "Infrastruktura e transportit", "Linjat e ujësjellësve, ato elektrike dhe të telekomunikacionit", "Ndërtime komplekse në kantieret industriale" dhe "Punime të tjera"), i atribuohet në masën më të madhe punimeve të lidhura me linjat e ujësjellësve, elektrike dhe ato të telekomunikacionit.*

Përmirësimi i lehtë i treguesit të besimit në ndërtim sugjeron për rritje më të moderuar të aktivitetit ndërtues gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016 krahasuar me periudhën e mëparshme[24].

Grafik 27. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Sektori i industrisë u karakterizua nga zhvillime në kahun rënës në tremujorin e tretë të vitit 2016. Vlera e shtuar e industrisë rezultoi 2.4% më e ulët krahasuar me tremujorin e tretë të një viti më parë, pas rritjes vjetore me 3.3% në tremujorin e mëparshëm. Dekompozimi sipas degëve dëshmon se "Industria nxjerrëse, energjia, uji dhe trajtimi i mbetjeve" kontribuoi në kahun rënës me 2.4 pikë përqindje në ecurinë e sektorit, ndërkohë që ndikimi i industrisë përpunuese rezulton pothuajse i papërfillshëm. Më konkretisht, vlera e shtuar e "Industrisë nxjerrëse, energjisë, ujit dhe trajtimit të mbetjeve" u tkurr me 4.7% në terma vjetorë, duke pasqyruar kryesisht vijimin e tendencës rënëse të industrisë nxjerrëse[25]. Ndërkohë, vlera e shtuar e "Industrisë përpunuese" thelloi më tej prirjen ngadalësuese gjatë tremujorit në analizë, duke regjistruar rënie vjetore me 0.3%, pas rritjes së ulët me 0.3% një tremujor më parë[26].

[24] *Pavarësisht rënies së normës së shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim gjatë tremujorit të katërt, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ajo vijon të mbetet mbi mesataren historike dhe nivelin e të njëjtës periudhë të një viti më parë.*

[25] *Sipas të dhënave të tërthorta, indeksi i vëllimit të prodhimit industrial regjistroi rënie të lartë vjetore me 39.3% në degën e industrisë nxjerrëse, duke vijuar tkurrjet e forta të dy tremujorëve të parë të vitit, përkatësisht rreth 39.4% dhe 35%. Gjithashtu, të dhënat e tregtisë me jashtë për këtë industri të orientuar kryesisht nga eksportet dëshmojnë se ecuria e eksporteve në vlerë mbetet në kahun rënës për grupet "Lëndë djegëse minerale, vajra minerale dhe produkte të distilimit të tyre" (-31.2% në T3 nga -51.5% në T2) dhe "Kripëra, sulfure, okside, gëlqere dhe çimento" (-6.3% në T3 nga -0.3% në T2), ndërsa grupi "Xeherorë, zgjyra dhe hiri" shënoi rritje vjetore në tremujorin e tretë të vitit 2016. Ndërkohë, indeksi i vëllimit të prodhimit industrial reflekton vijim të zhvillimeve pozitive në degën "Energji elektrike, furnizim me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar", duke shënuar rritje vjetore me 22.1% në tremujorin referues.*

[26] *Eksportet e produkteve të lidhura me industritë tekstile, të veshjes, të lëkurëve dhe të këpucëve, me peshën më të lartë në degën e industrisë përpunuese, ngadalësuan ritmet e rritjes vjetore, duke sugjeruar një mbështetje të industrisë përpunuese në një masë më të vogël nga këto aktivitete në tremujorin e tretë të vitit 2016.*

Treguesi i besimit dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në industri mbeten mbi mesataret historike gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016. Gjithashtu, rritja në vlerë e disa prej grupeve të eksporteve të produkteve industriale sinjalizon përmirësime të sektorit të industrisë gjatë tremujorit të katërt.

4.2.2. KËRKESA AGREGATE

Kërkesa agregate vazhdoi të zgjerohet gjatë tremujorit të tretë 2016, e mbështetur si nga kërkesa e brendshme, ashtu edhe nga ajo e huaj. Formimi i kapitalit rezultoi përcaktuesi kryesor në këtë drejtim. Krahas tij, edhe konsumi i popullatës e konsumi publik gjeneruan kontribute pozitive në rritje. Eksportet neto ofruan një kontribut të lartë pozitiv të mbështetur nga ecuria e shërbimeve të lidhura kryesisht me aktivitetin e turizmit. Informacionet nga tregues të tërthortë sugjerojnë vijim të rritjes së kërkesës agregate gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016.

Kërkesa e brendshme u zgjerua me 4.0% gjatë tremujorit të tretë, një normë kjo e ngjashme me atë të tremujorit të dytë. Kontributi kryesor pozitiv ka ardhur nga formimi i kapitalit fiks, fluksi i të cilit u zgjerua me 11.9% në terma realë vjetorë. Kontribute suplementare pozitive kanë ardhur nga konsumi. Brenda kësaj kategorie, konsumi i popullatës u zgjerua me 1.6%, ndërkohë që konsumi publik u zgjerua me 2.8%. Treguesit e tërthortë sasiorë dhe cilësorë të lidhur me tregtinë e jashtme, sektorin financiar, të dhënat e vrojtimeve dhe sektorin fiskal, sugjerojnë se kërkesa e brendshme do të vijojë të rritet edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016.

Grafik 28. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme.



* Indekset janë ndërtuar mbi shumë rrëshqitëse katërtremujore të vlerave reale.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Konsumi privat regjistroi rritje për të pestin tremujor radhazi. Ai u rrit me 1.6% në tremujorin e tretë të vitit 2016. Kjo normë ishte më e ulët se në tremujorin e dytë,

Grafik 29. Ecuria e konsumit privat



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

e ndikuar edhe nga një bazë krahasuese më e lartë[27]. Rritja e konsumit privat në tremujorin e tretë u përkthye në një kontribut prej 1.3 pikësh përqindjeje në rritjen e kërkesës agregate. Konsumi privat regjistroi rritje në të tre kategoritë përbërëse, mallra konsumi, shërbime dhe mallra të qëndrueshme, gjykuar nga tregues të tërthortë[28]. Mbështetje pozitive në rritjen e konsumit dha rritja e të ardhurave të disponueshme, e cila u ndikua kryesisht nga rritja e punësimit, ritmet pozitive të treguesit të fondit të pagave dhe nga zgjerimi i remitancave gjatë tremujorit të tretë të vitit. Në terma realë, rritja e të ardhurave të disponueshme u mbështet nga prania e vlerave të ulëta të inflacionit. Gjithashtu, ulja e pasigurisë[29] dhe e normave të interesit ka ndikuar pozitivisht në prirjen e konsumatorëve për të shpenzuar. Lehtësimi i standardeve të kreditimit gjatë dy viteve të fundit ka qenë një tjetër faktor me ndikim pozitiv në trendin rritës të kredisë për konsum. Në muajin nëntor, rritja e saj arriti në 11.4%, duke nxitur pozitivisht prirjen për konsum.

Tregues të ndryshëm të shpenzimeve konsumatore mbështesin vlerësimin për rritje të mëtejshme të konsumit privat në tremujorin e katërt të vitit 2016. Në balancë, treguesit cilësorë nga vrojtimet paraqesin një pamje më optimiste sesa treguesit e tërthortë sasiorë. Kështu, treguesit e besimit në sektorët e shërbimeve dhe të tregtisë qëndrojnë mbi mesataret historike në tremujorin e katërt. Bazuar

Grafik 30. Tregues të tërthortë për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e katërt



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[27] *Në tremujorin e tretë të vitit 2015, konsumi i popullatës u rrit me 3.1% pasi kishte rënë me 3.3% në tremujorin e dytë.*

[28] *Gjykuar nga rritja vjetore e indeksit të tregtisë me pakicë të mallrave ushqimore, importi i autoveturave dhe vlera e shtuar e sektorit të shërbimeve. Llogaritë kombëtare tremujore nuk publikojnë rezultate për konsumin e disagreguar sipas kategorive përbërëse.*

[29] *Treguesi i pasigurisë së konsumatorëve, i matur nëpërmjet Vrojtimit të Besimit, është në një trend rënës gjatë vitit, pasi arriti vlerën më të lartë të tij në tremujorin e parë të vitit 2016.*

në vrojtimin e aktivitetit kreditues, bankat kanë lehtësuar kushtet e kreditimit dhe raportojnë se kërkesa e konsumatorëve për kredi në tremujorin e katërt është rritur. Treguesi i besimit konsumator regjistroi gjithashtu rritje. Të dhëna sasiore që mbështesin rritjen e shpenzimeve konsumatore janë rritja në terma nominalë e importit të mallrave ushqimore dhe e importit të mjeteve motorike për pasagjerë; kredia konsumatore, e cila gjykuar mbi të dhëna të muajve tetor dhe nëntor 2016 ka vijuar të mbështesë shpenzimet familjare.

Investimet vijuan rritjen në tremujorin e tretë të vitit 2016, duke qenë përcaktuesit kryesorë të zgjerimit të kërkesës agregate. Rritja e investimeve (11.9%) në tremujorin e tretë, ishte 5.8 pikë përqindje më e lartë se rritja e tyre në gjashtëmujorin e parë. Ky komponent formoi 65% të kërkesës së brendshme. Rritja e investimeve në total reflektoi rritje në dy komponentët kryesorë përbërës: investimet në ndërtim dhe në makineri dhe pajisje[30]. Faktorët që ndikuan pozitivisht investimet gjatë tremujorit të tretë ishin: gjallërimi gradual i kërkesës konsumatore për produkte dhe shërbime, përmirësimi i besimit të bizneseve, lehtësimi i kushteve financiare, rritja e numrit të lejeve të ndërtimit, si dhe investimet e huaja direkte. Burimet e financimit të investimeve u mbështetën nga përmirësimi i gjendjes financiare të bizneseve[31], rritja e kredisë dhënë për qëllime investimi, si dhe rritja e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte.

Grafik 31. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore



Burimi: INSTAT.

Të dhëna të tërthorta sinjalizojnë se investimet do të vijojnë të japin kontribut pozitiv në rritjen e kërkesës agregate në tremujorin e katërt. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorët kryesorë të ekonomisë është rritur dhe qëndron mbi mesataren historike gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016. Tregues paraprijës për zhvillimin e investimeve është rritja e numrit të lejeve të ndërtimit përgjatë vitit të kaluar, rritja e kredisë për qëllime investimi dhe përmirësimi i gjendjes financiare të bizneseve.

[30] *Kategoritë e investimeve publikohen nga INSTAT vetëm me frekuencë vjetore. Për rritjen e investimeve sipas kategorive dëshmon zgjerimi i vlerës së shtuar në sektorin e ndërtimit dhe rritja e importit të makinerive dhe pajisjeve në tremujorin e tretë.*

[31] *Matur nëpërmjet vrojtimit të besimit të biznesit.*

Grafik 32. Tregues afatshkurtër të investimeve për tremujorin e katërt



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 1: ECURIA E ÇMIMEVE NË TREGUN E BANESAVE[32]

Pasi ndaloi rritjen në tremujorin e tretë të vitit 2016, indeksi i çmimit të banesave, u rrit me 4% në tremujorin e katërt. Gjatë vitit 2016, indeksi i çmimeve u rrit me 4.6% në terma mesatarë vjetorë. Indeksi i qirasë së banesave ka regjistruar gjithashtu rritje me 3.3% në tremujorin e katërt. Në terma mesatarë, gjatë vitit 2016, indeksi i qirasë shënoi rënie me 4.4%. Raporti i indeksit të çmimit ndaj qirasë së banesave u zhvendos lehtë në një nivel më të lartë gjatë vitit 2016, duke reflektuar ecurinë në kahe të kundërta të çmimeve dhe qirasë së banesave.

Grafik 33. Indeksi i çmimit dhe i qirasë së banesave dhe raporti i tyre



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[32] *Analiza e çmimit dhe e qirasë së banesave bazohet vetëm në informacion mbi çmimet dhe qiratë në qytetin e Tiranës.*

Kërkesa e sektorit publik dhe politika fiskale[33]

Sipas të dhënave të publikuara për 11-mujorin e parë të vitit 2016, politika fiskale ka qenë konsoliduese, e reflektuar në vlera të larta suficiti buxhetor. Në ndryshim nga pjesa e parë vitit, korrektimi fiskal u mbështet kryesisht nga rritja e të ardhurave tatimore gjatë periudhës korrik-nëntor 2016. Nga ana tjetër, shpenzimet buxhetore në gjysmën e dytë të vitit kanë favorizuar në një masë më të ulët procesin e konsolidimit fiskal. Në gjashtëmujorin e parë të vitit, shpenzimet ranë me rreth 6.8% në terma vjetorë, ndërkohë që gjatë periudhës korrik-nëntor ato shënuan një rritje vjetore me 3.5%.

Grafik 34. Orientimi i politikës fiskale*



* Grafiku paraqet ndryshimin e deficitit primar të krijuar brenda një viti (shuma rrëshqitëse për 4 tremujorë) në terma të PBB-së nga e njëjta periudhë e një viti më parë. Vlerat në boshtin pozitiv tregojnë impuls pozitiv fiskal dhe anasjelltas.
Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit të BSh-së.

Suficiti buxhetor në fund të 11-mujorit u vlerësua në rreth 0.5% të PBB-së. Regjistrimi i vlerave pozitive për balancën buxhetore përgjatë pjesës më të madhe të vitit ishte një fenomen i hasur vetëm në vitin 2007. Megjithatë, fundi i vitit pritet të mbyllet me deficit buxhetor, duke reflektuar dhe përqendrimin e lartë të nivelit të shpenzimeve buxhetore në këtë periudhë të vitit.

Shpenzimet buxhetore të realizuara gjatë muajve tetor e nëntor ishin rreth 73.2 miliardë lekë ose rreth 4.2% më të larta në terma vjetorë. Sikurse dhe në tremujorin e tretë të vitit, shpenzimet e kryera për pushtetin lokal vijojnë të drejtojnë rritjen e totalit të shpenzimeve edhe përgjatë muajve tetor e nëntor. Nga ana tjetër, shpenzimet kapitale kanë shënuar një rënie të lehtë me rreth 2% në terma vjetorë. Konsumi final i qeverisë vlerësohet të kontribuojë pozitivisht në rritjen e kërkesës agregate në tremujorin e katërt të vitit 2016.

[33] *Të dhënat më të fundit fiskale të disponueshme deri në datën 18 janar 2017 i përkasin publikimit të Ministrisë së Financave për 11-mujorin 2016 në linkun: http://wwwwww.financa.gov.al/al/raportime/programimi-ekonomiko-fiskal/raporte-dhe-statistika-fiskale-mujore/statistika-fiskale-mujore.*

Grafik 35. Ecuria e shpenzimeve buxhetore



Burimi: Ministria e Financave.

Në 11 muajt e parë të vitit 2016, shpenzimet buxhetore ishin rreth 361.2 miliardë lekë ose rreth 2% më të ulëta në terma vjetorë. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura përgjatë vitit 2015 vijon të ketë ndikim të konsiderueshëm në ndryshimet vjetore të shpenzimeve gjatë vitit 2016. Duke përjashtuar efektin e tyre, shpenzimet buxhetore për 11 muajt e parë të vitit 2016 rezultojnë rreth 2.8% më të larta në terma vjetorë, ku 91% e kësaj rritjeje është formuar nga kategoria e shpenzimeve korrente.

Të ardhurat buxhetore gjatë muajve tetor e nëntor u realizuan në rreth 69.8 miliardë lekë, duke shënuar një rritje me rreth 9.2%, nga e njëjta periudhë e një viti më parë. Rritja e të ardhurave gjatë këtyre dy muajve është arritur kryesisht në sajë të ecurisë së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të ardhurave nga tatimi mbi fitimin. Nga ana tjetër, të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe

Grafik 36. Ecuria e të ardhurave buxhetore



Burimi: Ministria e Financave.

nga tatimi mbi të ardhurat personale, kanë ndikuar negativisht në rritjen e totalit të të ardhurave gjatë kësaj periudhe.

Për periudhën 11-mujore, të ardhurat buxhetore rezultuan rreth 368.3 miliardë lekë, duke shënuar një rritje vjetore me rreth 7.3%. Gjatë vitit 2016, të ardhurat janë mbështetur nga kontributet e të ardhurave nga sigurimet sociale dhe tatimi mbi fitimin. Nga ana tjetër, kontributi i të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar[34], ka pësuar një ngadalësim gradual përgjatë vitit. Rregullimet ligjore të ndërmarra për këtë vit buxhetor, procesi i formalizimit, ambienti ekonomik, si edhe ecuria e importeve mbeten faktorët përcaktues të trajektores së të ardhurave fiskale përgjatë këtij viti.

Kërkesa e huaj dhe tregtia e jashtme

Deficiti real tregtar në mallra dhe shërbime u ngushtua në tremujorin e tretë të vitit 2016. Ngushtimi vjetor në terma realë vlerësohet në 16.8%. Përcaktuesi kryesor në këtë zhvillim ka qenë rritja e eksportit të shërbimeve me 25.4% në terma realë vjetorë. Nga ana tjetër, eksporti i mallrave ka vazhduar të tkurret, duke u pakësuar me 1.7% në terma vjetorë. Përsa i përket importeve, ato u zgjeruan me 5.6% me ndikim kryesor nga rritja e importit të mallrave me 7.0%. Gjithashtu, importet e shërbimeve janë shtuar me 3.1% në terma realë vjetorë.

Grafik 37. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Të dhënat mbi ecurinë e eksporteve dhe importeve të mallrave për vitin 2016 përfshijnë statistikat për tremujorin e katërt të vitit. Deficiti tregtar në mallra u ngushtua me rreth 6.8% në terma vjetorë, i ndikuar kryesisht nga rritja e eksporteve.

Eksporti i mallrave në vlerë u zgjerua me rreth 15.5% në nivel vjetor. Kontributi kryesor në këtë ecuri ka ardhur nga rritja e eksportit të kategorive "Tekstile dhe këpucë". Kontribute në rritje kanë ardhur edhe nga kategoria "Minerale, lëndë djegëse dhe energjie elektrike". Ky fenomen lidhet me eksportet mjaft të larta të xeherorëve në muajt nëntor dhe dhjetor, kryesisht në drejtim të Kinës dhe Turqisë. Nxitja e prodhuesve vendas për të eksportuar lidhet me rritjen e konsiderueshme të çmimeve të ofruara nga partnerët (veçanërisht nga Kina) gjatë këtyre dy muajve. Brenda së njëjtës kategori, në muajin dhjetor janë vënë re edhe disa sinjale pozitive (në terma të rritjes vjetore) të nëngrupit "Lëndë djegëse". Kontribute pozitive kanë ardhur edhe nga kategoria e "Materialeve të ndërtimit dhe metaleve" si pasojë e rritjes së eksporteve të kësaj kategorie gjatë muajit dhjetor drejt vendeve fqinje. Së fundi, kontributet pozitive të

[34] *Të ardhurat nga TVSh-ja, zënë një peshë të lartë, rreth 32% në totalin e të ardhurave.*

kategorisë "Ushqime, pije, duhan" kanë vijuar edhe gjatë tremujorit të katërt. Eksportet më të larta të frutave (tetor) dhe zarzavateve (nëntor dhe dhjetor) kanë qenë përcaktuesit e kësaj dinamike.

Grafik 38. Ecuria vjetore e çmimit të naftës në tregun Brent, e eksportit të naftës vendase (majtas), e indeksit të çmimit të metaleve dhe e eksportit të metaleve vendase (djathtas)



Burimi: INSTAT, FMN, EIA.

Aktiviteti importues rezultoi me një rritje prej 1.6% në terma vjetorë, rritje kjo e ngadalësuar në krahasim me tremujorët e kaluar të vitit. Kontributet kryesore pozitive burojnë nga kategoritë "Tekstile dhe këpucë", "Produkte kimike dhe plastike" dhe "Materiale ndërtimi dhe metale". Ndryshe nga tremujorët e mëparshëm, importet e kategorisë "Makineri, pajisje, pjesë këmbimi" rezultojnë të pakësuara krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, importet e kategorisë "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" vazhdojnë tendencën pakësuese në terma të rritjes vjetore.

Grafik 39. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT.

Sipas orientimit gjeografik, disa zhvillime të reja vihen re në aktivitetin e eksporteve. Peshat e Kinës dhe Turqisë janë rritur gjatë muajve nëntor dhe dhjetor, si pasojë e eksportit mjaft të lartë të xeherorëve. Rritja e eksporteve të "Materialeve të ndërtimit dhe metaleve" ka ndikuar në rritje të peshave për Kosovën dhe Maqedoninë. Gjithashtu, eksportet në rritje të produkteve bujqësore vazhdojnë të japin ndikim në rritjen e peshave të vendeve fqinje.

Përsa i përket zhvillimeve të gjithë vitit 2016, deficiti tregtar është zgjeruar me rreth 6.8% krahasuar me vitin 2015. Kjo ecuri është përcaktuar nga rritja vjetore e importeve në masën 6.3%. Kontributet në rritjen e importeve kanë ardhur kryesisht nga kategoritë "Makineri, pajisje, pjesë këmbimi", "Tekstile dhe këpucë" dhe "Materiale ndërtimi dhe metale". Kontribute më të ulëta pozitive kanë ardhur edhe nga kategoritë e tjera me përjashtim të kategorisë "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" importet e së cilës janë pakësuar në terma vjetorë.

Nga ana tjetër, eksportet janë rritur me vetëm 0.1% gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin e mëparshëm. Kontribut të qenësishëm pozitiv ka dhënë kategoria "Tekstile dhe këpucë" me kontribute suplementare nga "Ushqime, pije, duhan". Nga ana tjetër, dy kategoritë e mëdha "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" dhe "Materiale ndërtimi dhe metale" shfaqin ndryshime vjetore negative pavarësisht disa sinjaleve pozitive gjatë dy muajve të fundit të vitit 2016.

HAPËSIRË INFORMUESE 2: ZHVILLIMET NË BILANCIN E PAGESAVE NË TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2016

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 207.6 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2016, duke u ngushtuar me rreth 33.6% në nivel vjetor. Ai u vlerësua në nivelin 7.7% ndaj PBB-së nominale ose rreth 4.4 pikë përqindje më i ulët se në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Sipas zërave përbërës të llogarisë korrente, kontribut në kahun ngushtues dhanë përmirësimet e lidhura me llogaritë e shërbimeve dhe të ardhurave dytësore, me kontribute suplementare edhe nga të ardhurat parësore. Nga ana tjetër, llogaria e tregtisë së mallrave prodhoi kontribute në kahun zgjerues.

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve u zgjeruan me rreth 18.1%, ndërsa importet u rritën me rreth 6.1% në terma vjetorë. Bilanci neto pozitiv i llogarisë së të ardhurave dytësore u zgjerua me 18.9% në nivel vjetor. Kontributet kryesore në këtë ecuri kanë buruar nga llogaria e remitancave. Flukset hyrëse të remitancave shfaqën ecuri rritëse në terma vjetorë për herë të parë pas një viti duke u zgjeruar me rreth 13.5%. Deficiti i të ardhurave parësore u ngushtua në terma vjetorë, duke dhënë kontribut të kahut pakësues mbi ecurinë vjetore të deficitit të llogarisë korrente. Në terma strukturorë, i matur sipas hendekut kombëtar midis kursimeve dhe investimeve, sektori privat luajti rol kryesor në thellimin e deficitit korrent.

Bilanci i pagesave rezultoi me mjete të rezervës të pakësuara me 56.1 milionë euro. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016, stoku i rezervës valutore ishte rreth 2.76 miliardë euro. Ky nivel ishte i mjaftueshëm për mbulimin me 6.8 muaj import mallrash dhe shërbimesh dhe 170% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

	T1 '15	T2 '15	T3'15	T4 '15	T1 '16	T2 '16	T3'16
Llogaria korrente (në mil euro)	-230.9	-163.2	-312.7	-397.7	-224.2	-353.8	-207.6
vmv (%)	-20.7	-48.6	5.7	4.0	-2.9	116.7	-33.6
/ PBB-së (%)	-10.2	-6.0	-12.1	-14.7	-9.4	-12.6	-7.7
Mallra dhe shërbime	-372.9	-360.6	-476.3	-564.5	-403.3	-555.2	-410.9
vmv (%)	-7.2	-24.8	1.3	4.4	8.2	54.0	-13.7
Eksporte, f.o.b.	593.5	705.9	785.0	714.7	608.5	716.8	926.9
vmv (%)	2.9	-1.0	-2.3	-0.7	2.5	1.5	18.1
Importe, f.o.b.	966.4	1066.5	1261.4	1279.1	1011.9	1272.0	1337.8
vmv (%)	-1.2	-10.5	-1.0	1.5	4.7	19.3	6.1
Udhëtime neto	43.6	76.4	64.5	51.6	67.3	72.8	153.1
Të ardhura parësore	-38.8	-12.9	-12.8	-34.2	10.0	-15.1	-6.5
Kredi	36.4	34.5	40.0	43.9	50.8	44.9	42.7
Debi	75.2	47.4	52.8	78.1	40.7	60.1	49.2
Të ardhura neto nga Investimet Direkte	-50.5	-26.4	-27.7	-31.7	-3.8	-23.9	-21.7
Të ardhura dytësore	180.7	210.2	176.4	201.0	169.1	216.6	209.8
Kredi	211.9	243.3	219.1	247.2	205.0	249.7	250.3
Debi	31.2	33.0	42.6	46.2	35.9	33.2	40.5
Dërgesa nga emigrantët -neto	141.8	161.7	139.7	153.9	135.7	153.6	159.1
vmv (%)	19.9	17.6	-15.4	-10.0	-4.2	-5.0	13.9
Llogaria kapitale	26.0	21.3	45.6	32.8	6.6	7.2	3.1
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-205.0	-141.9	-267.1	-364.8	-217.7	-346.6	-204.5
Llogaria financiare	-163.5	-177.1	-126.6	-243.3	-163.7	-253.6	-71.9
vmv (%)	-32.7	-17.9	-30.9	-16.8	0.1	43.2	-43.2
/ PBB-së (%)	-7.2	-6.5	-4.9	-9.0	-6.8	-9.1	-2.7
Investime direkte	-253.9	-196.5	-248.1	-120.0	-143.6	-240.1	-276.4
vmv (%)	20.3	45.0	2.4	-46.1	-43.4	22.2	11.4
Investime portofoli	-74.7	-66.8	-11.2	-172.1	107.5	-8.7	-2.1
Derivativë financiarë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	53.3	70.0	-179.7	-120.3	-77.9	-4.8	262.7
Mjetet e rezervës	111.8	16.2	312.5	169.1	-49.6	0.0	-56.1
Gabime dhe harresa	41.5	-35.2	140.5	121.5	54.0	93.0	132.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.3. GJENDJA CIKLIKE E EKONOMISË DHE PRESIONET E BRENDSHME INFLACIONISTE

Analiza dhe vlerësimet e përditësuara me informacionin më të fundit mbi performancën ekonomike në vend, sugjerojnë për vijim të prirjes ngushtuese të hendekut negativ të prodhimit përgjatë vitit 2016. Zhvendosja e ekonomisë drejt potencialit ka nxitur prirjen rritëse të inflacionit bazë. Në një periudhë afatmesme, përmirësimi gradual i rritjes ekonomike dhe përdorimi më intensiv i faktorëve prodhues pritet të shtojnë presionet për rritjen e pagave, kostove të tjera prodhuese dhe inflacionit bazë dhe të kontribuojë në kthimin e inflacionit në objektiv.

